

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 54, datë 30.1.2019

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE TË DETAJUARA MBI TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të pikës 4 të, nenit 102 të Kushtetutës dhe shkronjës “a”, të pikës 2, të vendimit nr. 781, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e formatit dhe mënyrës së publikimit të të dhënave të detajuara, mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institu-cioneve publike të arsimit të lartë, mbi bazë mujore.

2. Format i publikimit, i cili do të përmbajë të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet e institucioneve publike të arsimit të lartë, kryhet sipas aneksit A, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Brenda datës 15 të çdo muaji, raportimi financiar nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij urdhri, rakordohet me degën e thesarit përkatëse dhe publikohet në faqen zyrtare të IAL-së përkatëse.

4. Brenda datës 20 të çdo muaji, institucionet publike të arsimit të lartë përcjellin raportimin financiar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri, në format elektronik pranë Qendrës Ndërinstitu-cionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila e publikon në faqen e saj zyrtare.

5. Administratorët e institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrojnë dhe përditësojnë sipas afateve të përcaktuara të dhënat sipas këtij udhëzimi edhe pranë Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucionet publike të arsimit të lartë dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj

UNIVERSITETI _____ / FAKULTETI _____

[illegible]

Shpenzimet nga të ardhurat e veta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzimet për ndërtime Shpenzimet për rikonstruksione, Shpenzimet për blerje biblioteka, Shpenzimet për blerje aparate, pajisje kompjuterike, Shpenzimet për blerje programe e softe kompiuterike etj. Shpenzimet për blerje pajisje, mobilie etj.											
Shpenzimet e personelit për: paga, orë jashtë kohës normale të punës, shpërblime të tjera (për dalje në pension, sëmundje të rëndë apo rast fatkeqësie në familje); Shpenzimet për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ; Shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve, të nevojshme për funksionimin e veprimtarisë së përditshme të institucionit (ujë, energji elektrike, shpenzime telefonike, posta, ngrohje, shërbime të sigurimit dhe ruajtjes, kancelari, materiale zyre, karburant, pjesë këmbimi etj.) Shpenzimet për dieta e udhëtime për punonjësit e institucionit kur largohen jashtë qendrës së punës ose jashtë shtetit për çështje pune. Shpenzimet për qiramarrje ambientesh, pajisjesh, mjete transporti etj. Shpenzimet për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largime nga puna, ekzekutim të detyrime kontraktuale të papaguara; Shpenzimet për honorare; pagesa e bordeve të organeve kolegjialë të institucionit; Shpenzimet për pagesat për veprimtaritë kërkimore - shkencore. Shpenzimet për bursat e studentëve Shpenzimet për bursat e ekselencës Shpenzime të tjera (në varësi të dinamikës së veprimtarisë së IAL-së)*											

Shënim:

* Përshkrimet e tabelës mund të shtohen në varësi të zërave specifike të të ardhurave dhe shpenzimeve të regjistruara nga çdo LAL, bazuar në veprimtarinë konkrete që kryen secili prej tyre.